

MINISTRI

Nr. 1056 prot.

Tiranë, më 27.3.2018

Drejtuar: KOMISIONIT TË EDUKIMIT DHE MJLTEVE TË INFORMIMIT  
PUBLIK  
KUVENDI I SHQIPËRISË

Tiranë

Në vijim të kërkesës suaj nr. 989 datë 15.03.2018 lidhur me disa pyetje për cështjen e teatrit kombëtar, ju informoj si më poshtë vijon:

Përsa i përket pyetjes suaj të parë lidhur me pikën 1, ju bëjmë me dije se rishikimi i VKM-së nr. 180, datë 13.04.2000 "Për Shpalljen Ansambël Monument Kulture të Aksit Kryesor dhe Qendrës Historike të Qytetit të Tiranës", është bërë nisur nga problematikat serioze që evidentoheshin në të si:

1. Terminologjia e pasaktë, emërtimi në VKM-ë "Ansambël Monument kulture" nuk ekziston në Ligjin nr. 9048, datë 07.04.2003 "Për trashëgiminë kulturore" (i ndryshuar) dhe në VKM Nr. 426, datë 13.7.2007 "Për miratimin e Kartës Shqiptare të Restaurimit"
2. Mungesa e hartës identifikuese për kufijtë e zonës së mbrojtur të trashëgimisë, Kufijtë e "Ansambllit Monument Kulture" dhe qendrës historike të qytetit të Tiranës në VKM-në nr. 180, datë 13.04.2000 janë të shprehura vetëm në mënyrë narrative me emra rrugësh të pandarë nga një zonë në tjetrën dhe nuk shoqërohen me hartë e koordinata ku të përcaktoheshin qartë kufijtë e asaj që cilësohej si "Ansambël Monument Kulture" dhe të qendrës historike.
3. Mungesa e zonës mbrojtëse e Qendrës Historike "Zona mbrojtëse" është një territor i cili duhet të qarkojë çdo qendër historike, roli i së cilës është mbrojtja e vlerave historike-kulturore të Q.H si dhe duke krijuar e mundësuar një kalim gradual të zhvillimit nga Q.H. drejt pjesëve të tjera të qytetit.
4. Mungesa e rregullores së administrimit të "Ansambllit Monument Kulture" dhe "Qendrës Historike" të qytetit të Tiranës.

Në këto kushte u hartua dhe miratua VKM nr. 325, datë 12.04.2017 "Për Shpalljen Qendrës Historike të Qytetit të Tiranës dhe miratimin e rregullores për administrimin e saj dhe zonës së mbrojtur përreth"

Vlen të theksohet se kufiri i zonës të trashëgimisë i cituar në VKM-së nr. 180, datë 13.04.2000, jo vetëm që nuk është zvogëluar por në disa pjesë është edhe zgjeruar në VKM nr. 325, datë 12.04.2017.

Bazuar në vlerat historike-kulturore kjo zonë tashmë është strukturuar në Qendrën Historike të qytetit të Tiranës, e cila përbëhet prej tre grupimeve me karaktere të ndryshme urbanistike



e arkitektonike që shtrihen në aksin Veri-Jug të Q.H. në përputhje me perimetrat e ndryshme historike të zhvillimit si dhe në zonën mbrojtëse të saj. Propozimi i ri respekton dhe thekson hapësirat me vlerë historike në fushën e trashëgimisë kulturore.

VKM-ja në fjalë shoqërohet nga rregullorja e administrimit, e cila përcakton detyrimet dhe mënyrat për administrimin e vlerave historiko - kulturore të Qendrës Historike dhe të Zonës mbrojtëse të qytetit të Tiranës. Ajo është mbështetur në Ligjin nr. 9048, datë 07.04.2003 "Për trashëgiminë kulturore" (i ndryshuar) dhe në VKM Nr. 426, datë 13.7.2007 "Për miratimin e Kartës Shqiptare të Restaurimit".

Në përputhje me vlerat e çdo zone rregullorja përcakton kritere për ndërhyrjet konservuese dhe restauruese. Po kështu është evidentuar kategorizimi i monumenteve që ndodhen në Qendrën Historike, në zonën mbrojtëse, apo në pjesët e tjera të qytetit dhe kriteret për ndërhyrjet në to.

Ndërkohë që vetë godina e Teatrit Kombëtar nuk është konsideruar asnjëherë si objekt me karakteristika të vecanta arkitektonike apo estetikë për t'u klasifikuar me status "monument kulture" dhe VKM 325 nuk ka sjellë asnjë ndryshim të statusit të vetë godinës së Teatrit Kombëtar.

Për administrimin e Q.H. dhe të zonës së saj mbrojtëse, rregullorja përcakton gjithashtu dhe mënyrat e bashkëpunimit të institucioneve të specializuara të MK me Bashkinë e qytetit, si dhe me institucionet, organizatat dhe subjektet e ndryshme për mbrojtjen më efektive të vlerave kulturore të qytetit.

Ju bëjmë më dije së VKM nr. 325, datë 12.04.2017 "Për Shpalljen Qendrës Historike të Qytetit të Tiranës dhe miratimin e rregullores për administrimin e saj dhe zonës së mbrojtur përreth" është e shpallur në Fletoren Zyrtare dhe në ëbësite-t e Publikimeve Zyrtare.

Përsa i përket pyetjes suaj të dytë aktualisht jemi në fazën ku në Bashkinë Tiranë ka ardhur një shprehje interesi mbi zhvillimin e zonës pranë Teatrit Kombëtar me një propozim për një koncept projekti për vetë Teatrin Kombëtar. Stafet e Bashkisë Tiranë dhe të Ministrisë së Kulturës janë në komunikim mbi propozimin e paraqitur.

Ka dy ekspertiza të bëra në këto 4 vite të kryera nga specialistët e IMK, të iniciuara me kërkesë të Drejtorit të TK, i shqetësuar për gjendjen e rënduar të godinës në institucion. Së fundi drejtori i është drejtuar edhe Institutit të Ndërtimit me anë të një shkrese zyrtare për të zhvilluar ekspertizë më të plotë, e cila përfshin një skanimin të detajuar teknik të godinës dhe sapo ka ardhur dhe po studiohet.

Lidhur me pyetjen tuaj të tretë sikurse theksuam me lart, nuk ka një vendimarrje nga Qeveria mbi projektin konkret. Ka shprehje të vullnetit politik për të ndërtuar një Teatër të Ri Kombëtar.

Jemi ende në fazën e studimit dhe analizimit të një propozimi mbi zhvillimin e zonës së Teatrit Kombëtar. Këtë vullnet dhe këtë propozim e kemi ndarë gjerësisht me opinionin publik, me komunitetin e artistëve dhe atë të arkitektëve si dhe me mediat. Ndjekim me vëmendje reagimet, diskutimet dhe sugjerimet e tyre.



(Jo hap do vjorime la ndajme edhe ne te ardhmen me te gjitha grupet e interesit. Diskutimet qe po zhvillohen jane pjesë e ketij procesi.

Në përgjigje të pyetjes suaj të katërt, theksojmë se duke qenë se ende nuk është vlerësuar koncepti-projekti i derguar ne Bashkiqe e Tiranës, Ministria e Kulturës nuk disponon një studim fizibiliteti për teatrin e ri të propozuar. Ndërsa ekspertizat mbi gjendjen tejet të amortizuar të godinës kryer gjatë katër viteve të fundit i ka ndarë tashmë me ju, gjendje qe konfirmohet edhe nga vetë artistët dhe stafi I TK. Një fakt I tillë konfirmohet tashmë edhe nga ekspertiza e e fundit e Institutit të Ndërtimit.

Konkretisht:

Në vijim të kërkesës së ardhur nga Drejtori i Teatrit Kombëtar për disa problematika në godinën e Teatrit Kombëtar, në mars 2014 një grup specialistësh të Institutit të Monumenteve të kulturës shkuan në objekt për inspektimin dhe vlerësimin e gjendjes së objektit. Në informacionin e dhënë nga specialistët rezultoi se gjendja e përgjithshme e objektit paraqitet tejet e amortizuar.

Gjatë viteve në objekt është ndërhyrë pjesërisht në rifiniturë dhe në mirëmbajtjen e pjesëve të dukshme të tij. Megjithëse janë kryer ndërhyrje të pjesshme në strukturë, elementet bazë të strukturës janë tejet të amortizuara.

Në nëntor 2014, Drejtori të Teatrit Kombëtar njofton për një problematikë tjetër emergjente në disa nga ambientet e Teatrit Kombëtar. Pas inspektimit grupi i specialistëve vlerësoi se ambientet ndihmëse ishin jashtë kushteve teknike për shfrytëzim nga aktorët gjatë shfaqjeve pasi në dhomat e zhveshjes se aktorëve ka pasur shembje të dyshemesë dhe shkëputje të mureve ndarës, si pasojë e çedimit të murit jashtëm me përbërje populiti.

Në këto kushte në nëntor 2014 IMK kërkoi të bëhej izolimi i këtyre ambienteve nga pjesa tjetër e teatrit me panele ndarëse derisa të bëhej i mundur rehabilitimi i tyre.

Duke vlerësuar situatën, specialistët e IMK hartuan projektin "Për ndërhyrje konsoliduese në Teatrin Kombëtar", projekt i cili u miratua nga KKR në vitin 2015.

Në Dhjetor 2015, Drejtori i Teatrit Kombëtar njofton për një tjetër rënie të pjesshme të çatisë në repartin e përgatitjes së dekoreve qer fat të mire nuk pati dëme në njerëz.

Menjëherë grupi i specialistëve të IMK inspektoi objektin dhe hartoi projektin per "Restaurimin e repartit të dekoreve, projekt i cili u miratua nga KKR në vitin 2016, zbatim i të cilit u financua nga Ministria e Kulturës në vlerën 2.010.587 lekë.

Së fundi drejtori i Teatrit Kombëtar i është drejtuar edhe Institutit të Ndërtimit me anë të një shkresë zyrtare për të zhvilloar ekspertizë më të plotë, e cila përlëshin një skanim të detajuar teknik të godinës. Kjo ekspertizë sapo ka ardhur dhe po studiohet, por ajo thekson se godina e TK referuar vlerësimit të eksperteve "jo vetëm që nuk plotëson asnjë standard bashkëkohor lidhur me anën funksionale, sigurinë e strukturës sistemet e ruajtjes nga zjarri, elektrik, ngrohjes et.) por edhe nëse kryet rikonstruksioni i saj, sado i kushtueshëm dhe i thellë të jetë, nuk e sjell atë në kushtet optimale teknike të sotme sipas kodeve të projektimit."



Përsa i përket pyetjes tuaj lidhur me studimin e vitit 1999 nuk disponojmë informacion për një studim të tillë.

Sikurse theksuam më lart, edhe në përgjigje të pyetjes suaj të pestë jemi ende në fazën e studimit dhe analizimit të kërkesës mbi zhvillimin e zonës pranë Teatrit Kombëtar.

Sikurse theksuam më lart, edhe në përgjigje të pyetjes suaj të gjashtë theksojmë sërish në jemi ende në fazën e studimit dhe analizimit të kërkesës mbi zhvillimin e zonës pranë Teatrit Kombëtar.

Lidhur me pyetjen tuaj të shtatë, informojmë se projektuesi nuk është angjuzuar dhe as paguar me financa publike.

Koncept-projekti i propozuar nga Bjärke Ingels vjen si një shprehje interesi nga subjekti privat. Sikurse theksuam më lart, jemi ende në fazën e studimit dhe analizimit të kërkesës mbi zhvillimin e zonës pranë Teatrit Kombëtar.

Përsa i përket pyetjes suaj së tetë nëse do të ketë partneritet publik privat kjo mbetet për t'u saktësuar pasi të jetë vlerësuar concept-projekti për të cilin sikurse sqaruam jemi ende në fazën e studimit dhe analizimit të kërkesës, por edhe të përcaktimit të procedurave të mëtejshme mbi zhvillimin e zonës pranë Teatrit Kombëtar.

Lidhur me informacionin e kërkuar në pyetjen e nëntë tuajës, informojmë se fondi i grantit grek, në dakordësi me Qeverinë Greke, është tashmë programuar për t'u investuar tek projekti tjetër i madh që po ndjek Ministria e Kulturës, atë të rindertimit të një Teatri tjetër Kombëtar, të Operas dhe Baletit dhe Ansambllit Popullor.

Jo nuk është kërkuar një ndihmë e tillë pranë Qeverisë Italiane dhe BE-se. Me të dy këta partner të rëndësishëm jemi në një listë të gjatë bashkëpunimesh në fushën e Trashëgimisë Kulturore.

Sikurse theksuam më lart, edhe në përgjigje të pyetjes suaj të dhjetë, informojmë se jemi ende në fazën e studimit dhe analizimit të kërkesës mbi zhvillimin e zonës pranë Teatrit Kombëtar.

Në përgjigje të pyetjes suaj të njëmbëdhjetë ju informojmë se deri tani është prezantuar nga arkitekti i mirënjohur Bjärke Ingels, vetëm një koncept për një Teater të ri, dhe jo një projekt i plotë. Nuk disponojmë informacione për një pretendim të tillë.

Lidhur me kërkesën e paraqitur në pyetjen tuaj të fundit, ju informojmë se arkitekti Bjärke Ingels e ka propozuar konceptin e tij pranë Bashkisë Tiranë.

MINISTRI  
Mirëla KUMBARO FURXHI  
REPUBLIKA E SHQIPËS  
MINISTRI E KULTURËS  
DHE TRASHËGIMISË  
KULTURORE  
TIRANË